REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 200/20
Datë/Datum. 23.03.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **TERMOKOS sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i prokurimit	**TER-19-038-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me valvola dhe filtera**

1. Identifikimi i ankuesit*

ALFA.I SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ibrahim Rugova pn.

(Adresa)

Lipjan — *14 000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

00383 38 606 706 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Lulzim JAHAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@alfa-i.com

(Adresa elektronike)

23.03.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

Limited Liability Company alfa i Construction - Engineering - Trade

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 17.12.2019 Data e hapjes së ofertave: 09.01.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK: 04.03.2020 Kërkesa për rishqyrtim dt:09.03.2020 Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:11.03.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Dosja është dorëzuar me anc te platformës elektronike te prokurimit, procesverbalin e hapjes e kemi pranuar nga ajo platforme.

Limited Liability Company alfa.i Construction · Engineering & Trade

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.04.03.2020, ku e kanë rekomanduar për kontratë OE "Business Pro" SH.P.K, ndërsa neve na ka eliminuar me arsyetimin se *"Katalogu me specifikacionin teknik i ofruar nga ana juaj nuk e përmbush kërkesën e AK-së të saktësuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit pasi që është kërkuar temperatura të jetë 130 gradë ndërsa ju në katalogun tuaj keni ofruar materiale me temperaturë prej 70 gradë".* Fillimisht ju rikujtojmë se AK-ja ne njoftimin mbi vendimin të dt.14.02.2020 na ka shpallur neve si operator ekonomik të rekomanduar për kontratë, ndërsa OE "Business Pro" SH.P.K e ka shpallur si tenderues të eliminuar. Ndërsa pas eliminimit OE "Business Pro" SH.P.K ka bërë kërkesë për rishqyrtim ku AK-ja e ka pranuar si pjesërisht të bazuar kërkesën e tij dhe e ka kthyer lëndën në rivlerësim, ndërsa pas rivlerësimit e ka

Limited Liability Company alfa-i Construction Engineering & Trade

rekomanduar për kontratë të njëjtin operator edhe pse ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin të dt.14.02.2020 e ka eliminuar me arsyen si në vijim: "*Sipas komisionit të vlerësimit të tenderit OE Business Pro sh.p.k. për pozicionet 1-10 në ofertën e tij ka ofruar katalogun FAF6000 për valvola Ovale ka ofruar tipin F4 (valvola pa funde të vazhduar), ndërsa kërkesa në dosje të tenderit ka qen dimensioni i tipit F5 (me funde të vazhduara për izolim), ndërsa valvolat e ofruara në katalogun e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara ne FDT dhe tek njoftimi për kontratë*".

Duke u bazuar në të gjitha faktet që u përmendën më lartë shihet qartë se AK-ja po bie në kundërshtim me vendimin e saj të kaluar, sepse edhe pse në herën e parë e ka shpallur si tenderues të eliminuar OE e lartpërmendur, pas rivlerësimit e ka rekomanduar për kontratë, edhe pse është i papërgjegjshëm dhe nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë ashtu siç e cekëm edhe më lartë.

Në lidhje me arsyen e AK-së për eliminimin tonë ju sqarojmë se nuk qëndron dhe është diskriminuese për ne si OE sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, gjithashtu këtë fakt se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e ka pranuar edhe vetë AK-ja ku na ka rekomanduar për kontratë në njoftimin mbi vendimin e dt. 14.02.2020.
Gjithashtu në lidhje me arsyen e eliminimit ju sqarojmë se ne e plotësojmë këtë kërkesë në dosje të tenderit dhe tek njoftimit për kontratë. **(Bashkangjitur keni deklaratën e prodhuesit ku mund të shihet qartë se prodhuesi në fjalë, prodhon edhe materiale me temperaturë 130 gradë).**

Ne me dt.11.03.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, por vetëm i ka përsëritur arsyet për të cilat jemi eliminuar duke mos dhënë asnjë fakt ligjor. Madje në vendimin për refuzim AK-ja është treguar shumë kundërthënëse, ku në njërën anë thotë se i keni plotësuar të gjitha kërkesat por keni ofruar çmim më të lartë, ndërsa në anën tjetër thotë se nuk komisioni i rivlerësimit ka hasur në lëshime teknike përkatësisht mangësi teknike tek oferta jonë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët** sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

Limited Liability Company
alfa.f
Construction - Engineering & Trade

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **ALFA.I SH.P.K.**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Limited Liability Company
alfa.i
Construction, Engineering & Tr...